



BULETINI

Shator 2011

Numër 8/2011

Përmbajtja

1. Aktivitetet nga Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL)

2. Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve për Avancim (PTA)

3. Aktivitetet nga Programin Fillestar për Arsimim Ligjor (PFAL)

4. Aktivitetet tjera

**ZHVILLIM
PRFESIONAL
GJYQËSOR**

Adresa: Lagja e Spitalit, Rr.
"Muharrem Fejza" pa.nr.
Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel&fax: +381 (0) 38 512 069 +381
(0) 38 512 081 +381 (0) 38 512 095
www.kjijudicial.org
info@kjijudicial.org

1. Aktivitetet nga Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL)

Tryezë pune – “Dëshmitarët e Mbrojtur”



Më 07 shtator 2011, IGJK, ka realizuar një tryezë pune nga lëmia penale, me temë “Dëshmitarët e Mbrojtur”.

Objektivë kryesore e kësaj tryeze ishte që gjyqtarët dhe prokurorët pas përfundimit të saj do të:

- Të avancojnë njohuritë e tyre rreth kompetencës lidhur me dëshmitarët e mbrojtur;
- Të identifikojnë se kur mund të shpallet dëshmitar i mbrojtur një person;
- Të vlerësojnë efektet e dëshmisë së këtyre dëshmitarëve në procedurën penale ;
- Të shpjegojmë papranueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarëve të mbrojtur si provë në procedurën penale;
- Të dallojnë rastet se kur shpallet një dëshmitar anonim;
-

Tryeza u realizua në formë të prezantimit të shkurtër teorik dhe diskutimit të shembujve nga praktika me fokus në rolin e prokurorit dhe gjyqtarit në procesin e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe sfidave të paraqitura gjatë praktikës.

Tryezë diskutimesh: “Konfiskimi i pasurisë së fituar me vepër penale”



Më 09 shtator 2011, IGJK organizoi tryezën e diskutimeve me temën e lartpërmendur. Në kuadër të kësaj tryeze u diskutuan çështjet e konfiskimit të pasurisë së përfituar me vepër penale, veprimet hetimore dhe shqyrtimi kryesor në të cilën vendoset për konfiskimin e pasurisë.

Objektivë kryesore e kësaj tryeze ishte që gjyqtarët dhe prokurorët pas përfundimit të saj do të jenë në gjendje që të:

- përcaktojnë masën e konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale;
- zbatojnë bazën ligjore për konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale;
- bëjnë dallimin në mes të konfiskimit të dobisë pasurore dhe kërkesës pasurore-juridike;
- zbatojnë procedurën e paraparë për konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me kryerjen e veprës penale;
- njohin se çka ndodhë me administrimin e pasurisë së konfiskuar.

Përfitues të kësaj tryeze ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha regionet e Kosovës.

Tryezë pune: “Kontrata për Kredinë”

Më 19 shtator 2011 IGJK në bashkëpunim me Programin për Sistemin e Përmbartimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve në Kosovë (SEAD) i Misionit të USAID-it, organizoi tryezën e punës me temë “Kontrata për Kredinë”.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte që të ofrojë njohuri të thelluara për kontratën për kredinë, nocionin, karakteristikat, natyrën juridike dhe format e saja.

Objektivë e kësaj tryeze ishte që gjyqtarët pas përfundimit të saj do të:

- interpretojnë dhe zbërthejnë nocionin e kontratës për kredinë dhe format e saja;
- zbërthejnë dhe kuptojnë elementët esenciale të kontratës për kredinë;
- interpretojnë dhe zbatojnë “klauzolat e kontratës për kredinë”;
- kuptojnë detyrimet e bankave dhe institucioneve mikrofinanciare lidhur me transparencën e normave të interesit për kredi dhe depozita;
- zgjerojnë njohuritë për ndalimin e kamatës në kamatë; kuptojnë rastet kur pushon rrjedhja e kamatës dhe interpretojnë kamatëvonesën;



- avancojnë njohuritë e tyre për mënyrat e llogaritjes së kamatës dhe kamatëvonesës.
-

Në kuadër të tryezës u trajtuan edhe të drejtat dhe detyrimet e kredidhënësit dhe kredimarrësit, kamata, kamatëvonesa, ri programimi i kredisë dhe llogaritja e kamatës. Tryeza u realizua në formë të një prezantim të shkurtër teorik, vazhdoi me një diskutim interaktiv dhe shqyrtim të shembujve nga praktika bankare dhe gjyqësore.

Përfitues të kësaj tryeze ishin gjyqtarë nga të gjitha regionet e Kosovës.

Seminar i Avancuar për Gjyqtarë dhe Prokurorë



Më 20 dhe 21 shtator 2011, IGJK në bashkëpunim me OSBE - Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (ODHIR), mbajti një seminar për gjyqtarë dhe prokurorë me temë “Shkëmbimi i Përvojave në Dënimin e Çështjeve për Krimet e Luftës me fokus në -Krimet e Luftës dhe Llojet e Përgjegjësiive”

Qëllimi i tryezës ishte avancimi i njohurive dhe shkëmbimi i përvojave lidhur me procedimin e rasteve të krimeve të luftës dhe njohja me Statutin

dhe praktikën gjyqësore të Tribunalit Ndërkombëtar për Krime të Luftës në ish Jugosllavi (ICTY). Seminari u fokusua në normat ligjore që përcaktojnë dhe sanksionojnë veprat penale të krimeve të luftës duke përfshirë instrumentet ndërkombëtare dhe legjislacionin vendor, llojet e përgjegjësiive dhe ndjekjen penale, si dhe rastet nga praktika gjyqësore e Tribunalit Ndërkombëtar për Krime të Luftës në ish Jugosllavi (ICTY).

Gjithashtu në këtë seminar gjyqtarët dhe prokurorët vendor prezantuan dhe diskutuan lidhur me përvojën e tyre në fushën e krimeve të luftës dhe praktikën gjyqësore në Kosovë, raste këto me të cilat janë marrë kryesisht gjyqtarë dhe prokurorë të UNMIK-ut dhe tani të EULEX-it.

Përfitues të kësaj tryeze ishin gjyqtarët penalistë, prokurorë nga Prokuroria e Shtetit dhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, të cilët në mbështetje të këtij programi do të marrin pjesë edhe në një vizitë studimore në Tribunalin e Hagës (ICTY), me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të gjyqësorit të Republikës së Kosovës në procedimin e lëndëve të krimeve të luftës.

Punëtori - Lëmia e Drejtësisë për të Mitur në Kosovë

Më 22, 23 dhe 24 shtator 2011, IGJK, në bashkëpunim me UNICEF-in ka mbajtur një punëtori me temë “Programi i Trajnimit për Trajner në fushën e Drejtësisë për të Mitur në Kosovë”. Objektivat kryesore të kësaj punëtorie ishin që pjesëmarrësit pas përfundimit të sajë do të jenë në gjendje të:

- zbatojnë praktikisht standardet legale kryesore të së drejtës ndërkombëtare në fushën e drejtësisë për të mitur;
- analizojnë normativën vendore në fuqi dhe faktin se si ta aplikojnë atë me rastin e vendosjes në praktikë;
- identifikojnë fushat kryesore problemore në lëmin e drejtësisë për të mitur;
- tejkalojnë sfidat e zbatimit të zbatimit të dispozitave të reja të Kodit të Drejtësisë për të Mitur;

- Hartojnë një draft propozim të modulit për trajnimet nga lëmi i drejtësisë për të mitur;
- Zhvillojnë një kornizë të temave që do të duhej të adresohen në modulin e trajnimit të drejtësisë për të mitur për gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës.

Pjesëmarrësit në këtë punëtori u njohën edhe me atë se si mund të zhvillojnë një trajnim efektiv nga lëmi i drejtësisë për të mitur duke përdorur metodat e mësimin interaktiv. Ndërsa me këtë rast është zhvilluar edhe procesi i përzgjedhjes së trajnuesve të IGJK-së nga lëmi i drejtësisë për të mitur.

Përfitues të kësaj punëtorie ishin gjyqtarë dhe prokurorë të cilët punojnë me rastet e të miturve, nga gjykatat dhe prokuroritë e të gjitha niveleve dhe regjioneve të Kosovës.

Tryezë diskutimesh: “Standardet ndërkombëtare kundër dhunës në familje, ligji kundër diskriminimit dhe çështjet pronësore”



Më 22 dhe 23 shtator 2011 IGJK në bashkëpunim me Qendrën Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI) dhe Qendrën për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Regjional (CLARD), projekt i mbështetur nga Komisioni Evropian Zyra në Prishtinë, organizoi tryezën e diskutimeve me temë: “Standardet ndërkombëtare kundër dhunës në familje, Ligji kundër Diskriminimit dhe çështjet pronësore”.

Pas përfundimit të këtyre tryezave, përfituesit do të jenë në gjendje që të:

- zbatojnë standardet ndërkombëtare në rastet e dhunës në familje;
- njohin përmbajtjen e dispozitave të Kushtetutës së Kosovës të cilat ndalojnë diskriminimin në Republikën e Kosovës;
- analizojnë dhe zbatojnë më drejtë dispozitat e Ligjit kundër Diskriminimit dhe Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje;

Zbatojnë më drejtë standardet ndërkombëtare në çështjet pronësore, pronësinë e përbashkët të bashkëshortëve dhe rastet kur cenohen të drejtat trashëgimore-pronësore të subjekteve të gjinisë femërore.

Gjatë realizimit të tryezës pati prezantime të shkurtra teorike, punë në grupe punuese, diskutim interaktiv dhe shqyrtim të rasteve nga praktika gjyqësore lidhur me standardet ndërkombëtare kundër dhunës në familje, dispozitat e Ligjit kundër Diskriminimit, dhunën në familje, divorcin si dhe çështjet pronësore (si pronësia e përbashkët e bashkëshortëve, e drejta e trashëgimisë së pronësisë nga gjinia femërore).

Përfitues të kësaj tryeze ishin gjyqtarë nga të gjitha regjionet e Kosovës.

Tryezë Diskutimesh: Praktikrat e Dënimeve



Më 26 shtator 2011, IGJK në bashkëpunim me Njësitin e Trajnimeve të EULEX –Misioni për Sundimin e Ligjit të BE në Kosovë, mbajti një tryezë diskutimesh me temë “Praktikat e Dënimeve”.

Qëllimi i tryezës ishte diskutimi rreth praktikës së dënimeve në Kosovë me qëllim të unifikimit të saj nga gjyqtarët vendorë dhe ndërkombëtarë në rastet me elemente të ngjashme si dhe shkëmbi i përvojave duke komentuar dhe krahasuar kodet penale të shteteve të ndryshme me Kodit Penal të Kosovës.

Në këtë tryezë prezantuan dhe diskutuan çështje me interes për këtë tryezë edhe përfaqësues të institucioneve si: Universiteti i Prishtinës,

Shërbimi Sprovues, Paneli për Lirimin me Kusht në MD, Shërbimi Korrektues dhe Avokatia.

Temat e trajtuara nga këta përfaqësues kishin të bëjnë me: filozofinë dhe qëllimin e dënimeve krahasuar me realitetin; çfarë ndodh me personat e dënuar dhe cilat janë opsionet e dënimit; masat alternative dhe mbikëqyrja e të burgosurve të liruar me kusht etj.

Meqë në këtë tryeze ishin prezent gjyqtarë dhe prokurorë nga vende të ndryshme (pjesë e misionit EULEX) ata diskutuan dhe prezantuan çështje që kishin të bënin me Praktikrat Ndërkombëtare të Dënimeve si:

Udhëzimet mbi dënimet nga SHBA, Praktikrat e dënimeve nga Portugalia, Praktikrat e dënimeve nga Italia, Marrëveshjen për pranimin e fajësisë, Llojet e dënimeve, minimumin dhe maksimumin e dënimeve, dhe çështje tjera me interes për pjesëmarrësit dhe sistemin e gjyqësor të Kosovës.

Në këtë tryezë u diskutua edhe procedura pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, dënimet, qëllimi i dënimeve, llojet e dënimeve, paraburgimi dhe burgu për të mitur, roli i shërbimit sprovues etj.

Përfitues të kësaj tryeze ishin: gjyqtarët penalistë vendor dhe të EULEX-it, nga niveli i qarkut, përfaqësues nga shërbimi sprovues, shërbimi korrektues, avokatia dhe ministria e drejtësisë.

Tryezë Diskutimesh “Krimi Financiar dhe Ekonomia Joformale”

Më 28 shtator 2011, IGJK ka organizuar një trajnim nga lëmia penale, me temë “Krimi Financiar dhe Ekonomia Joformale”.

Çështjet të cilat janë trajtuar gjatë kësaj tryeze kryesisht kishin të bëjnë me: Instrumentet Ligjore që sanksionojnë krimin financiar, konventat ndërkombëtare, ligjet vendore, funksionimi dhe kompetencat e Prokurorisë Speciale, burimet e korrupsionit, mënyrat e shkaktimit të korrupsionit në Prokurimin Publik, provat dhe sigurimi i tyre me rastin

e krimeve financiare.

Në këtë tryezë përveç tjerash u diskutuan çështje që kanë të bëjnë me parandalimin e krimit financiar si; miratimi i ligjit për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale, ndërtimi i mekanizmave për kontrollimin e agjencive të shitblerjes, bashkëpunimi me gjykata dhe banka si dhe rritjen e efikasitetit në ndjekjen penale.

Përfitues ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha nivelet dhe të gjitha regjionet e Kosovës

2. Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve për Avancim (PTA)

Shpërblimi i dëmit jo material dhe shpërblimi i këtij dëmi në rast aksidenti të shkaktuar nga automjetet në lëvizje

Më 20 shtator 2011, IGJK në kuadër të Programit të Trajnimeve për Avancim ka realizuar sesionin e radhës nga Moduli 2- E drejta Civile Materiale dhe Procedurale me temë: “Shpërblimi i dëmit jo material dhe shpërblimi i këtij dëmi në rast të aksidentit të shkaktuar nga automjetet në lëvizje”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte krijimi i praktikave më të mira dhe funksionale në procesin e kompensimit të dëmit jo material dhe zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore në këto raste.

Objektivë kryesorë ishte që pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi të jenë në gjendje të:

- identifikojnë elementet dalluese lidhur me dëmin material dhe jo material;
- zbatojnë dispozitat adekuate që kanë të bëjnë me shpërblimin e dëmit jo material;
- njohin rastet kur gjykata mund të caktojë shpërblim më të vogël nga sa është shuma e dëmit; dhe
- listojnë rrethin e personave që kanë të drejtën e kompensimit të dëmit jo material.



Gjatë këtij trajnimi u trajtuan në detale kriteret për përcaktimin e dëmit jo material, përgjegjësia e automobilistëve si dhe u trajtuan disa shembuj praktik të vendimeve gjyqësore të cilat kishin për objekt shpërblimin e dëmit jo material.

Përfitues të këtij trajnimi ishin kryesisht gjyqtarët e lëmisë civile të nivelit komunal dhe të qarkut.

Trajnim i Avancuar për Gjyqtarët Porotë



- kuptojnë rolin e tyre me rastin e vendosjes në praktikë të çështjeve statusore,
- dallojnë përbërjen e trupit gjykues për të mitur dhe për të rritur si dhe njohin sjelljen e mirë dhe të pahijshme në bazë të parimeve dhe rregullave të etikës së gjyqtarëve porotë.

Çështjet të cilat kanë qenë në fokus gjatë trajnimit kryesisht kishin të bënin me rolin e gjyqtarëve porotë në zbatimin e ligjit mbi familjen, roli i tyre në seancat gjyqësore për të rritur dhe të mitur, mënyrën e këshillimit dhe votimit si dhe etikën e sjelljes së gjyqtarëve porotë sipas parimeve të Kodit të Etikës për Gjyqtarë Porotë.

Më 29 shtator 2011, IGJK realizoi një sesion trajnues të avancuar dhe të karakterit regjional për gjyqtarët porotë.

Ndër objektivat e këtij trajnimi ishte që gjyqtarët porotë pas përfundimit të këtij sesioni të jenë në gjendje të:

Gjatë trajnimit për identifikimin e shkeljeve etike pjesëmarrësve iu prezantuan raste praktike me ç’rast ata punuan individualisht dhe demonstuan shkathtësitë e tyre në gjetjen e shkeljeve dhe sjelljeve të pahijshme.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë porotë nga regjioni i Prizrenit dhe Pejës.

Aktivitetet nga Programi Fillestar për Arsimim Ligjor (PFAL)

Trajnimet në PFAL IV

Trajnimet në fazën e parë dhe të tretë të PFAL IV kanë vazhduar edhe gjatë muajit shtator sipas orarit dhe programit trajnues.

Kandidatët kanë ndjekur trajnimet intensive (6 ditë në javë), ku tri ditë ditë të trajnimeve të fazës së parë kanë qene në IGJK, ndërsa 3 ditë të fazës së tretë kanë qene në gjykata përkatësisht prokurori varësisht nga profili, për të ndjekur trajnimet praktike. Trajnimet i kanë ndjekur 56 kandidatë.

Trajnimet gjatë fazës së tretë kanë ndjekur trajnimet në 12 module trajnuese si dhe disa trajnime të



specializuara, ndërsa gjatë fazës së tretë në bashkëpunim im dhe mbikëqyrjen mentorit kanë ndjekur trajnimet praktike në gjykata dhe prokurori, qëllimi i të cilave është ballafaqimi me situatat reale dhe raste konkrete, të cilat do të ndikojnë tek kandidatët në demonstrimin e shkathtësive praktike të nivelit të lartë gjatë marrjes me rastet në punën e tyre të mëvonshme si gjyqtar apo prokurorë.

Trajnimet e PFAL III

Muaji shtator ka qenë muaji i fundit i trajnimeve për gjeneratën e tretë e kandidatëve të Programit Fillestar për Arsimim Ligjor.

Gjatë këtij muaji kandidatët kanë ndjekur trajnimet praktike të fazës së tretë, përkatësisht fazës së mentorimit, sipas programit të përcaktuar nga IGJK në koordinim me Koordinatorët e Mentorëve.

Këto trajnime janë ndjekur nga 32 kandidatë.



Vizita në Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë



Me ftesë të Shkollës së Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë nga data 12-14 shtator një delegacion nga Instituti Gjyqësor i Kosovës ka realizuar një vizitë studimore.

Qëllimi i vizitës ka qenë ngritja e nivelit të koordinimit dhe bashkëpunimit për realizim të aktiviteteve trajnuese e kryesisht në realizimin e provimit për pranimin e kandidatëve të rinj për gjyqtarë dhe prokurorë në Programin Fillestar për Arsimim Ligjor në institucionet përkatëse.

Me këtë rast delegacioni i IGJK-së, përveç takimeve u angazhuan në cilësi të monitoruesve në procesin e provimit pranues të magjistratëve në Shkollën e Magjistraturës.

Nga ky proces IGJK nxori edhe disa rekomandime lidhur me avancimin e procesit të Provimit Përgatitor për kandidatët e PFAL në Institutin Gjyqësor të Kosovës.



Takimi me Mentor



Pas përfundimit të trajnimit me kandidatët e gjeneratës së tretë të Programit Fillestar për Arsimim Ligjor, me datë 30 shtator është organizuar një takim me Mentorët e kandidatëve me qëllim të diskutimit të rrjedhës së trajnimit në fazën e tretë të PFAL dhe marrjes së konfirmimit nga ana e Mentorëve për përfundimin me sukses të kësaj faze trajnimi nga kandidatët.



Në këtë takim u diskutuan shumë aspekte të kësaj faze trajnimi dhe dolën disa konkluzione me qëllim të ngritjes së performancës së kandidatëve dhe mentorëve gjatë trajnimeve praktike për kandidatët të cilat do të mund të inkorporoheshin në trajnimet e ardhshme praktike.

Takim me GIZ për fazën e tretë të PFAL

Në kuadër të bashkëpunimit me partnerë dhe donatorë ndërkombëtarë IGJK është duke punuar në një projekt rreth hartimit të një programi apo kurrikule për fazën e tretë të trajnimit në Programin Fillestar për Arsimim Ligjor.

Ky projekt është duke u mbështetur nga GIZ, me përfaqësuesit dhe ekspertët e të cilit janë realizuar disa takime për të diskutuar

lidhur me identifikimin e çështjeve që ata mund të mbështesin këtë fazë trajnimi.

Takimet janë realizuar me stafin e IGJK-së si dhe me mentorë të kandidatëve.

Nga këto takime është përpiluar një program dhe agjendë pune në të cilën ekspertë të kësaj fushe nga Gjermania do të paraqesin përvojat e tyre si dhe opsionet që do të mund të gjenin zbatim në Programin Fillestar për Arsimim Ligjor të IGJK-së

Kurs trajnimi: “E drejta Evropiane në praktikë: “Hyrje dhe Përqendrim në të drejtën civile”



Instituti Gjyqësor i Kosovës prej datës 12 deri me 16 shtator 2011 në bashkëpunim me Twinning Projekt EU-LER - Programi i Binjakëzimit për Reformim të Sistemit të Arsimimit Ligjor në Kosovë, mbajti një kurs pesëditor trajnimi me temën “E drejta evropiane në praktikë - Hyrje dhe përqendrim në të drejtën civile”.

Në këtë kurs trajnimi u trajtuan çështjet lidhur me të drejtën evropiane, historia e saj si dhe struktura organizative e Bashkimit Evropian, lidhja ne mes te së drejtës evropiane dhe KEDNJ dhe Gjykata e Drejtësisë e BE-së.

Në cilësi të trajnuesve u angazhuan dy ekspertë ndërkombëtarë në bashkëpunim me ekspert vendor të cilët janë certifikuar si trajnues të së drejtës së BE-së, nga po ky program trajnimi.

Në këtë kurs trajnues u diskutuan tema të ndryshme me interes për pjesëmarrësit si;

- Nocioni i “Bashkimit Evropian”, “Këshillit të Evropës dhe Këshillit Evropian”,
- Roli i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në Luxemburg,
- Roli dhe funksioni i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg,
- Të bëjnë dallimet në mes GJED në Luxemburg dhe GJEDNJ në Strasburg,
- Burimet ligjore të Bashkimit Evropian,
- Ndikimet rregulloreve dhe direktivave evropiane në ligjet vendore (nacionale),
- Raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në Luxemburg,

Përfitues të këtij trajnimi ishin kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë të gjeneratës së tretë nga PFAL në IGJK.



4. Aktivitetet tjera

Tryeza e punës e stafit e IGJK-së për hartimin e dokumenteve të brendshme të IGJK-së



Më 01 deri 04 shtator 2011 në Shqipëri, IGJK në mbështetje nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – UNDP, realizoi një tryezë pune për stafin e IGJK-së.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte hartimi i disa udhëzimeve administrative të brendshme dhe hartimi i Manualit për Trajnues të IGJK-së.

Këto dokumente do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në ngritjen e kapaciteteve të stafit për komunikim zyrtarë si dhe avancimin e metodologjisë së trajnimeve nga ana e trajnuesve të IGJK-së.

Si rezultat i kësaj tryeze janë hartuar dy udhëzime

administrative;

Udhëzimi Administrativ për Koordinim të Aktiviteteve me Donator dhe Udhëzimi Administrativ lidhur me Mënyrën dhe Format e Komunikimit Zyrtar si dhe Përgatitjen dhe Trajtimin e Dokumentacionit Zyrtar, ndërsa është hartuar edhe drafti i parë i Doracakut për Trajnues.

Trajnim i stafit të IGJK-së: “Shkrimi i Propozimeve, “ Ndërtimi i Ekipeve dhe Kreativiteti në Punë”

Më 08 dhe 09 shtator 2011 në Istog, IGJK në kuadër të projektit “Drejtësi për Barazi Gjinore” i mbështetur nga UNWOMEN, realizoi një me temë “Shkrimi i Propozimeve, Ndërtimi i Ekipeve dhe Kreativiteti në Punë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të stafit lidhur me hartimin e projekt propozimeve dhe ngritja e kapaciteteve për punën ekipore dhe kreativitetin në punë. Pas përfundimit të këtij trajnimi stafi i IGJK-së do të jetë në gjendje që të:

- Hartojë propozim projekte për donatorë me një përmbajtje të pranueshme, të arsyeshme dhe profesionale;Zhvillojë ide të ndryshme për hartimin e propozimeve lidhur me nevojat e IGJK-së;
- Avancojë punën ekipore dhe zhvillojë kreativitetin e tyre në punë.



Gjatë këtij trajnimi, kryesisht u zhvillua punua në grupe, me ç’rast pjesëmarrësit hartuan projekt propozime konkrete, zhvilluan dhe prezantuan ide për ngritjen e kapaciteteve të IGJK-së. Gjithashtu, përmes shembujve dhe demonstrimit praktik u zhvilluan diskutime dhe ide për ngritjen e nivelit të punës në ekip dhe kreativitetit në punë. Përfitues të këtij trajnimi ishte stafi i IGJK-së.

Tryeza regionale: Trajnerët e certifikuar të IGJK/UNWOMEN nga fusha e të Drejtave të Njeriut, zhvilluan trajnime në pesë regjione të Kosovës



Më 12 deri 16 shtator 2011, IGJK me mbështetje nga UNWOMEN, zyra në Prishtinë, realizoi trajnime njëditore në pesë regjionet e Kosovës me tema: Dhuna në Familje, Standardet Ndërkombëtare dhe Ligji për Barazinë Gjinore, të Drejtat e Fëmijëve dhe Trafikimi me Qenie Njerëzore.

Trajnerët e certifikuar për këtë qëllim nga IGJK dhe UN WOMEN, për herë të parë zhvilluan trajnime nga kjo fushë.

Qëllimi i realizimit këtyre tryezave ishte ngritja e kapaciteteve të gjyqësorit të Kosovës dhe aktorëve tjerë të sistemit të drejtësisë nga lëmia e të drejtave të njeriut dhe barazia gjinore.

Pas përfundimit të këtyre trajnimeve, përfituesit e tyre do të jenë në gjendje që të:

- zbatojnë më efektivisht në praktikë ligjet vendore dhe ndërkombëtare nga kjo fushë;
- zgjerojnë njohuritë e tyre për instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë lëmi,
- përkufizojnë procedurën që duhet zbatuar në rastet e veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore,

- të zbatojnë në mënyrë më efektive dhe efektive procesin e mbrojtjes së të drejtave të viktimave;
- kuptojnë më mirë nocionin, llojet dhe pasojat e dhunës në familje si dhe njohjen me procedurën që duhet zbatuar në ato raste.

Trajnimet e mbajtura nga kjo fushë u realizuan duke gërrshetur metodologjinë e trajnimit përmes prezantimit të pjesës teorike, rasteve praktike, punës në grupe dhe diskutimeve.

Pjesëmarrësve në këto trajnime iu ofrua material i hartuar nga trajnuesit si dhe legjislacioni ndërkombëtar dhe vendor që e rregullon këtë fushë.

Përfitues të këtyre trajnimeve ishin; gjyqtarë, prokurorë, zyrtarë të Policisë së Kosovës, Shërbimit Sprovues dhe Qendrës për Punë Sociale, nga të gjitha regjionet e Kosovës.

